



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

Prishtinë, korrik 2022

**FONDI PËR SHËRIMIN DHE RIKUPERIMIN E LËNDIMEVE TË SPORTISTËVE DHE PERFORMUESVE NË ART DHE KULTURË 2022-SPORT DHE KULTURË**

**Qëllimi i Fondit**

Bazuar në programin qeverisës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon përmirësimin e kushteve dhe krijimin e atyre të reja për zhvillimin e karrierave profesionale në fushën e sportit dhe kulturës.

Ndër prioritetet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2022 është mbështetja e individëve të cilët e zhvillojnë veprimtarinë e tyre profesionale në fushën e sportit dhe kulturës për tejkalimin e sfidave potenciale që mund të kenë gjatë karrierës së tyre aktive përmes Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve.

Fondi për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve synon mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve mjekësore për shërim apo rikuperim në rast të lëndimeve fizike që ndodhin përgjatë aktivitetit të tyre stërvitor/përgatitor apo garues/performues. Profesionistët në fushën e sportit dhe kulturës mund të aplikojnë në njërin apo të dy formatet e mbështetjeve të mëposhtme:

- 1. Mbështetja për Shërimin e Lëndimeve Sportive e Kulturore; dhe**
- 2. Mbështetja për Rikuperimin e Lëndimeve Sportive**

Në kuadër të mbështetjes “**Shërimi i Lëndimeve Sportive**” parashihet mbështetja e plotë ose/apo e pjesëshme e kostos financiare për intervenimet operative të përgjithshme apo specifike në rast të lëndimeve fizike të sportistëve, trajnerëve, referëve/gjyqtarëve apo artistëve. Ndërsa, në kuadër të mbështetjes “**Rikuperimi i Lëndimeve Sportive**” parashihet mbështetja e plotë ose/apo e pjesëshme e kostos financiare për seancat fizioterapeutike apo terapisë sportive të nevojshme për lehtësimin dhe përshpejtimin e rikuperimit të lëndimeve fizike të profesionistëve vendorë.

Thirrja e vitit 2022 në kuadër të Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive është e strukturuar në dy kategori duke përfshirë kritere të përgjithshme dhe të veçanta për të

dy grupet e synuara: mbështetje për profesionistët në fushën e sportit dhe mbështetje për profesionistët në fushën e kulturës.

### **Vlerësimi i aplikimeve do të zhvillohet në dy faza:**

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

### **Vlerësimi përmbajtësor që identifikon:**

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e sportit dhe kulturës;
- Nëse kostot e kërkesës janë reale karshi çmimeve të tregut të shërbimeve shëndetësore;
- Nëse aplikuesi ka përfunduar të gjitha obligimet paraprake ndaj MKRS-së (nëse është përfitues i thirrjeve paraprake);

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Specifikacionet e thirrjes janë të elaboruara më poshtë, duke zbërthyer kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, afatet kohore, procesin e aplikimit, si dhe shkallën maksimale të mbështetjes.

### **Kush mund të aplikojë:**

Aplikimi për mbështetje financiare në kuadër të Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive bëhet vetëm nga individët e profilizuar në fushën e sportit dhe të kulturës.

- Individët e regjistruar në Republikën e Kosovës, të cilët ushtrojnë veprimtaritë përkatëse profesionale në fushën e sportit, në Kosovë, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët e regjistruar në Republikën e Kosovës të cilët ushtrojnë veprimtaritë përkatëse profesionale në fushën e kulturës, në Kosovë, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;

Kjo thirrje publike nuk parasheh mbështetjen financiare për artistët të cilët janë anëtarë/punëtorë të institucioneve nacionale të kulturës në Kosovë, rrjedhimisht anëtarë/punëtorë të institucioneve vartëse të kulturës të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## **MBËSHTETJE PËR PROFESIONISTËT NË FUSHËN E SPORTIT**

### **Shërimi dhe rikuperimi i lëndimeve sportive**

#### **Kriteret e përgjithshme minimale për profesionistët e fushës së sportit të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Për sportistët nën moshën 18 vjeçare, çertifikata e lindjes dhe/ose pasaporta e fëmijës dhe letërnjoftimi i prindit/kujdestarit;
- Për aplikuesit nën moshën 18 vjeçare, dokumentacionet e kërkuara dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për të cilat të miturit nuk mund të japin përgjegjësi, duhet të plotësohen në emër të prindit/kujdestarit;
- Vërtetimin tatimor lidhur me obligimin ndaj tatimit në të ardhurat personale;
- Të dëshmojë arritjet profesionale në sportin përkatës e cila duhet të vërtetohet nga federata përkatëse (*CV-ja me arritjet profesionale*);
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Aplikuesi në Fondin për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj.
- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se një projekt në të njëjtën thirrje;

#### **Kriteret e veçanta për profesionistët e fushës së sportit të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Sportistët dhe trajnerët duhet të jenë anëtarë të klubeve sportive të cilat janë anëtare të Federatave Sportive të sportit përkatës në Republikën e Kosovës, ndërsa referët/gjyqtarët duhet të jenë zyrtarë të federatës përkatëse;
- Mbështetja financiare mund të kërkohet vetëm për lëndimet të cilat kanë ndodhur gjatë aktivitetit stërvitor apo garues të sportistit, referit/gjyqtarit ose trajnerit (*në këtë pikë përjashtohen lëndimet të cilat nuk janë të karakterit sportiv dhe të cilat mund të kenë ndodhur në hapësira jashtë vendit ku realizohet aktiviteti stërvitor apo garues*);
- Intervenimi operativ ose/apo trajtimi fizioterapeutik për të cilin kërkohet mbështetja financiare mund të kryhet në Institucionet Shëndetësore Publike apo Private të licencuara në Republikën e Kosovës apo në Institucionet Shëndetësore Publike dhe Private jashtë vendit (*aplikuesi mund të përkraket për intervenim apo trajtim të lëndimeve specifike jashtë vendit vetëm atëherë kur dëshmohet se shërbimi specifik për të cilin ka nevojë nuk ofrohet në institucionet shëndetësore vendore*);
- Mbështetja financiare mund të kërkohet edhe për trajtimin e lëndimeve që kanë ndodhur para hapjes së thirrjes së Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive (*në këtë pikë përfshihen lëndimet të cilat kanë ndodhur edhe përgjatë muajit janar të vitit 2021, deri në periudhën e hapjes së kësaj thirrjeje*);

- Intervenimi operativ apo trajtimi fizioterapeutik për të cilin kërkohet mbështetja financiare duhet të jetë me **Udhëzim të Mjekut** nga Institucionet Publike apo Private, vendore ose ndërkombëtare shëndetësore;
- **Raporti i Mjekut** duhet të përfshijë statusin shëndetësor të pacientit, diagnozën dhe trajtimin, me vulë dhe nënshkrim të mjekut nga Institucioni Shëndetësor në vend apo jashtë vendit;
- Shuma e kërkesës për financim duhet të jetë në përputhshmëri me **ofertën e institucionit** ku do të kryhet shërbimi shëndetësor (*aplikuesi duhet të dëshmojë çmimin e tregut për shërbim duke sjellur ofertën nga institucioni shëndetësor*);
- Në rastet kur aplikuesi aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërimin dhe rikuperimin e lëndimeve të cilat janë realizuar para hapjes së thirrjes, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin e pranuar nga institucionet shëndetësore përmes **raportit të mjekut, faturës së rregullt**, dhe **transaksionit bankar - për pagesa mbi 100 EUR**);
- Në rastet kur aplikuesi aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërbime mjekësore të cilat do t'i realizojë pas aplikimit për mbështetje financiare, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin që do të pranojë përmes: **raportit të mjekut**, dhe **pro-faturës së lëshuar nga institucioni shëndetësor ku do të realizojë intervenimin**);

## **MBËSHTETJE PËR PROFESIONISTËT NË FUSHËN E KULTURËS**

### **Shërimi dhe rikuperimi i lëndimeve - kultura**

#### **Kriteret e përgjithshme minimale për profesionistët e fushës së kulturës të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Për artistët nën moshën 18 vjeçare, çertifikata e lindjes dhe/ose pasaporta e fëmijës dhe letërnjoftimi i prindit/kujdestarit;
- Për artistët nën moshën 18 vjeçare, dokumentacionet e kërkuara dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta duhet të plotësohen në emër të prindit/kujdestarit;
- Vërtetimin tatimor lidhur me obligimin ndaj tatimit në të ardhurat personale;
- Të dëshmojë arritjet profesionale (CV-ja me arritjet profesionale);
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj.
- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se një projekt në të njëjtën thirrje;

**Kriteret e veçanta për profesionistët e fushës së kulturës të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Mbështetja financiare mund të kërkohe vetëm për lëndimet të cilat kanë ndodhur gjatë aktivitetit stërvitor apo performues të artistit *(në këtë pikë përjashtohen lëndimet të cilat mund të kenë ndodhur në hapsira jashtë vendit të punës ku realizohet aktiviteti stërvitor apo performuese);*
- Intervenimi operativ apo trajtimi fizioterapeutik për të cilin kërkohe mbështetja financiare mund të kryhet në Institucionet Shëndetësore Publike apo Private të licencuara në Republikën e Kosovës apo në Institucionet Shëndetësore Publike dhe Private jashtë vendit *(aplikuesi mund të përkraket për intervenim apo trajtim të lëndimeve specifike jashtë vendit vetëm atëherë kur dëshmohe se shërbimi specifik për të cilin ka nevoj nuk ofrohet në institucionet shëndetësore vendore. Për të dëshmuar, aplikuesi duhet të sjell mendim konziliar - mendimin e tre mjekve nga institucionet shëndetësore publike përmes së cilës konfirmohet se shërbimi i nevojshëm nuk ofrohet në Kosovë);*
- Mbështetja financiare mund të kërkohe edhe për trajtimin e lëndimeve që kanë ndodhur para hapjes së thirrjes së Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive *(në këtë pikë përfshihen të gjitha lëndimet të cilat kanë ndodhur edhe përgjatë vitit 2021, deri në periudhën e hapjes së thirrjes);*
- Intervenimi operativ apo trajtimi fizioterapeutik për të cilin kërkohe mbështetja financiare duhet të jetë me **Udhëzim të Mjekut** nga Institucionet Publike apo Private, vendore ose ndërkombëtare shëndetësore;
- **Raporti i Mjekut** duhet të përfshijë statusin shëndetësor të pacientit, diagnozën dhe trajtimin, me vulë dhe nënshkrim të mjekut nga Institucioni Shëndetësor në vend apo jashtë vendit;
- Shuma e kërkesës për financim duhet të jetë në përputhshmëri me **ofertën e institucionit** ku do të kryhet shërbimi shëndetësor *(aplikuesi/ja duhet të dëshmojë çmimin e tregut për shërbim duke sjellur ofertën nga institucioni shëndetësor);*
- Në rastet kur artisti/ja aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërimin dhe rikuperimin e lëndimeve të cilat janë realizuarë para hapjes së thirrjes, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin e pranuar nga institucionet shëndetësore përmes raportit të mjekut, faturës së rregullt, dhe transaksionit bankar - për pagesa mbi 100 EUR);
- Në rastet kur artisti aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërbime mjeksore të cilat do të realizoj pas aplikimit për mbështetje financiare, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin që do të pranoj përmes: raportit të mjekur, dhe pro-faturës së lëshuar nga institucioni shëndetësor ku do të realizoj intervenimin);

**Shkalla e mbështetjes:**

- Shkalla e mbështetjes (%) N.A.
- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit 10,000.00 Euro

**Aplikimi i individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në vijim:**

1. Formularin e aplikimit (të plotësuar dhe nënshkruar);
2. Formularin e propozim buxhetit (të plotësuar dhe nënshkruar);
3. Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës (për ata nën moshën 18 vjeç, çertifikata e lindjes së fëmijës dhe kopja e letërnjoftimit/pasaportës së prindit/kujdestarit);
4. Për aplikuesit nën moshën 18 vjeçare të cilët përfaqësohen nga kujdestari, akt dëshmi për kujdestari;
5. CV-ja me përgatitje profesionale (arritjet profesionale sportive);
6. Konfirmimin mbi llogarinë bankare të lëshuar nga banka përkatëse;
7. Vërtetimi nga Federata sportive përkatëse për anëtarësi në klubin përkatës (vetëm për sportist apo trajner);
8. Vërtetimin nga Federata sportive përkatëse për anëtarësi në federatën përkatëse (vetëm për referët/gjyqtarët);
9. Vërtetimi nga Federata sportive përkatëse vetëm në rastet kur sportisti/ja apo trajneri/ja është pjesë e reprezentacionit shtetëror, ose dëshminë që sportisti/ja janë pjesë e Supërligës apo Ligës së parë të sportit përkatës;
10. Kontrata e aplikuesit me klubin përkatës (në rast se sportisti/ja apo trajneri/ja nuk ka kontratë me klubin përkatës atëherë, Vërtetimin nga Federata Përkatëse për anëtarësi në klubin përkatës është i mjaftueshëm);
11. Kontrata e aplikuesit me klubin përkatës (në rast se gjyqtari/referi nuk ka kontratë me federatën përkatës atëherë, Vërtetimin nga Federata Përkatëse për anëtarësi është i mjaftueshëm);
12. Raporti i Mjekut që përfshin statusin shëndetësor të pacientit, diagnozën dhe trajtimin, me vulë dhe nënshkrim të mjekut nga Institucioni Shëndetësor në vend apo jashtë vendit;
13. Për mbështetjen e intervenimeve jashtë vendit: tri raporte mjeksore duke përfshirë institucionet publike dhe private përmes së cilave dëshmohet se shërimi apo rikuperimi i lëndimit sportiv nuk mund të realizohet në institucionet shëndetësore në Republikën e Kosovës;
14. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat do të realizohen pas aplikimit në thirrjen e Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive:
  - 14.1 Profaturë e institucionit shëndetësor vendor ku do të kryhet intervenimi apo seancat e rikuperimit (profatura e vulosur e institucionit shëndetësor t'i bashkëngjitet Formularit për propozim të buxhetit);
  - 14.2 Ofertën e çmimeve të tregut të lëshuar nga institucioni shëndetësor;
15. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat janë realizuar para aplikimit në thirrjen e Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive:
  - 15.1. Fatura e rregullt e institucionit shëndetësor ku është realizuar intervenimi;
  - 15.2. Dëshmi mbi transaksionin bankar për të gjitha faturat në vlerë mbi 100 EUR;

15.3. Raporti mjeksor;

16. CD ose USB me të gjitha dokumentet e kërkuara nga lista në trajtë PDF.

## **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM**

### **Për profesionistët e fushës së kulturës**

#### **Aplikimi i individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në vijim:**

1. Formularin e aplikimit (të plotësuar dhe nënshkruar);
2. Formularin e propozim buxhetit (të plotësuar dhe nënshkruar);
3. Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës (për të moshën nën 18 vjeç, çertifikata e lindjes së fëmijës dhe kopja e letërnjoftimit/pasaportës së prindit/kujdestarit);
4. Për artistët nën moshën 18 vjeçare të cilët përfaqësohen nga kujdestari, akt dëshmi për kujdestari;
5. CV-ja ose portfolio me përgatitje profesionale (arritjet profesionale artistike);
6. Konfirmimin mbi llogarinë bankare të lëshuar nga banka përkatëse;
7. Kontrata e artistit me institucionin përkatës në kuadër të së cilit zhvillon veprimtarinë e tij/saj (nëse artisti/ja ka marrëdhënie kontraktuale me punëdhënësin);
8. Raporti i Mjekut që përfshin statusin shëndetësor të pacientit, diagnozën dhe trajtimin, me vulë dhe nënshkrim të mjekut nga Institucioni Shëndetësor në vend apo jashtë vendit;
9. Për mbështetjen e intervenimeve jashtë vendit: tri raporte mjeksore duke përfshirë institucionet publike dhe private përmes së cilave dëshmohet se shërimi apo rikuperimi i lëndimit sportiv nuk mund të realizohet në institucionet shëndetësore në Republikën e Kosovës;
10. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat do të realizohen pas aplikimit në thirrjen e Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive:
  - 10.1 Profaturë e institucionit shëndetësor vendor ku do të kryhet intervenimi apo seancat e rikuperimit (profatura e vulosur e institucionit shëndetësor t'i bashkëngjitet Formularit për propozim të buxhetit);
  - 10.2 Ofertën e çmimeve të tregut të lëshuar nga institucioni shëndetësor;
    11. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat janë realizuar para aplikimit në thirrjen e Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive:
      - 11.1. Fatura e rregullt e institucionit shëndetësor ku është realizuar intervenimi;
      - 11.2. Dëshmi mbi transaksionin bankar për të gjitha faturat në vlerë mbi 100 EUR;
      - 11.3. Raportin mjeksor;
    12. CD ose USB me të gjitha dokumentet e kërkuara nga lista në trajtë PDF.

#### **1. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Individët duhet të aplikojnë në Fondin për Shërimin dhe Rikuperimin e lëndimeve sportive vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në ueb-faqen e MKRS-së: [www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org). Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Kërkesa konsiderohet se është dorëzuar brenda periudhës së ftesës nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së ftesës, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në zyrë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Dokumentet e kompletuara brenda zarfit të formatit A4, duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në trajtë fizike, në adresën e mëposhtme:

***Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit***

***Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës***

**Titulli që duhet shënuar në pjesën e jashtme të zarfit:**

**APLIKIM PËR THIRRJEN PUBLIKE NË FONDIN PËR SHËRIMIN DHE RIKUPERIMIN E LËNDIMEVE SPORTIVE 2022**

**Emri, mbiemri dhe adresa e aplikantit.**

**Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune pas hapjes së thirrjes dhe përfundon me datën: 26 gusht 2022, në ora 15:59.

**Më shumë informacione rreth thirrje publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike “**Fondi për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive 2022**” mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [Enver.Tahiraj@rks-gov.net](mailto:Enver.Tahiraj@rks-gov.net) për sportistët; dhe [jehona.shyti@rks-gov.net](mailto:jehona.shyti@rks-gov.net) për artistët, jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

**2. DOKUMENTACIONI SHITESË DHE KONTRAKTIMI:**

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të komisionit, MKRS-ja mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët e përzgjedhur dhe mund të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale



në lidhje me aktivitetet e propozuara. Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më shumë se 10 ditë), përfituesi do të refuzohet.